

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: MIREMBAJTJE DHE SHERBIM I RIPARIMIT TE AUTOMJETEVE DHE MAKINERIVE

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):34330000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 11,100,000 leke (Pa tvsh)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kukes, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 .;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatoret ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitet ligjor, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi

Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se vlera e parashikuar e Kontrates.
b. Kopje e vertetuar të bilanceve të tre viteve të fundit (2020, 2021 dhe 2022) të paraqitur pranë Administratës Tatimore të konfirmuar nga ky autoritet. *ku të paktën në dy bilance nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit*”.

c. Operatori ekonomik duhet të paraqes vërtetimin për likuidimin e taksave vendore për vitin fiskal 2022.

(Për plotësimin e kriterit të mesipërm është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas shtojcës Nr.9 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit). Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe ligjit 9632 për taksat vendore (i ndryshuar). Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Nisur nga vlera e xhiros vjetore që deklarohet nga subjekti ekonomik, varet kapaciteti financiar i tij i cili përkthehet në kapacitet për të realizuar kontratën objekt prokurimi

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar

Bazuar në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë I ndryshuar”*Çdo tatimpagues përparë deklarohen vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji .Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës (**4,440,000**) Lek pa Tvsh që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, **kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës**, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

c).AK kërkon për realizimin e kontratës një punësim mesatar për 4 (kater) punonjës, të vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për pagim detyrimesh dhe për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (tetor –nëntor-dhjetor 2022) (3 muajt e fundit)

Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën (tetor-nëntor-dhjetor2022).

Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe nenin 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

d).Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë **me deklaratë** si subjekt ekonomik ,se ka në përbërje të servisit pajisjet e mëposhtme:

- pajisje balancim gomash,	copë 1 (një);
- pajisje montim-zmontim gomash,	copë 1 (një);
- aparat saldimi me oksigjen	copë 1 (një);
- aparat saldimi me argon	copë 1 (një);
- bankë-provë për dinamo, motorino	copë 1 (një);
- pajisje për testimin e injektoreve.	copë 1 (një);
- aparat për kontroll radiatorit uji	copë 1 (një);
- pajisje për mbledhjen e vajit të motorit	copë 1 (një);
- ure ngritëse për automjete	cope 4 (kater);

Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe nenin 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

e).Operatori ekonomik duhet te paraqes nje deklarate mbi cilesine dhe standartet teknike te pjeseve te kembimit.

g).Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte vijon:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Karrotrec	2 cope	Pronesi ose qera

Per te deshmuar kete, operatoret ekonomike duhet te paraqesin dokumentat e meposhtme:

- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, nese jane ne pronesi, duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor.
- Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publik, nese jane me qera, duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor, si dhe kontrata perkatese e qerases e vlefshme per gjate zbatimit kontrates me AK.

Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 "Rekomandim mbi hartimin e kritereve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik